



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

**VENDIM**

**Nr. 99, dt. 01.06.2015**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të konservimit dhe restaurimit në Kalanë e Shkodrës.  
*Të kufizohet rrethimi me parmakë druri vetëm në pjesët ku është e nevojshme.  
Parmaku të mos vendoset mbi murë por me distancë nga muret.  
Tek qemeri i daljes sekrete të bëhet vetëm plotësimi i nevojshëm dhe konsolidimi i saj.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**